

20070921191

## L I G J PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN GJATË PUNËS

### I. DISPOZITAT THEMELORE

#### Neni 1

Me këtë ligj përcaktohen masat për sigurinë dhe shëndetin gjatë punës, obligimet e punëdhënësit, të drejtat dhe obligimet e të punësuarve nga sfera e sigurisë dhe shëndetit gjatë punës, si dhe masat preventive kundër rreziqeve profesionale, mënjanimi i faktorëve të rrezikshëm për fatkeqësi, informimi, konsultimi, aftësimi i punëtorëve dhe përfaqësuesve të tyre dhe pjesëmarrja e tyre në planifikimin dhe ndërmarrjen e masave të sigurisë dhe shëndetit gjatë punës.

#### Neni 2

(1) Dispozitat e këtij ligji zbatohen në të gjitha veprimtaritë e sektorit publik dhe privat, për të gjithë personat e siguruar nga lëndimi në vendin e punës ose sëmundjet profesionale sipas dispozitave të sigurimit pensional, invalidor dhe shëndetësor dhe për të gjithë personat tjerë që janë të inkuadruar në proceset e punës.

(2) Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen në veprimtaritë nëse me dispozitë të veçantë është e rregulluar kjo materie (forcat e armatosura, policia, në disa aktivitete të veçanta të forcave për mbrojtje dhe shpëtim).

(3) Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen për ndihmëset shtëpiake.

#### Neni 3

Termet që shfrytëzohen në këtë ligj e kanë kuptimin si vijon:

- "I punësuar" është personi i punësuar sipas marrëveshjes për punësim dhe angazhim në çfarëdo baze tjetër juridike, i vetëpunësuar, veprimtari profesionale bujqësore ose veprimtari tjetër dhe personi i cili kryen punë në vendin e punës si pjesë e programit për aftësim;

- "Punëdhënësi" është personi fizik ose juridik i cili i shfrytëzon shërbimet e të punësuarit sipas marrëveshjes për punësim, personi fizik ose juridik i cili i shfrytëzon shërbimet e të punësuarit në çfarëdo baze tjetër juridike, bujk ose person fizik i cili, në mënyrë të pa varur ose me ndonjë anëtarë të familjes së tij, kryen veprimtari bujqësore ose veprimtari tjetër, si profesion i tij i vetëm ose kryesor dhe që nuk punëson persona tjerë;

- "Përfaqësuesi i të punësuarve për sigurinë dhe shëndetin gjatë punës" është personi i zgjedhur nga ana e të punësuarve që ti përfaqësojë interesat e tyre në drejtim të sigurisë dhe shëndetit gjatë punës para punëdhënësit (në tekstin e mëtejshëm: përfaqësuesi);

- "Masat preventive" janë të gjitha masat që ndërmerren ose që planifikohen në të gjitha nivelet e punës te punëdhënësi, për shkak të pengimit ose zvogëlimit të rreziqeve ndaj sigurisë dhe shëndetit gjatë punës;

- "Vendi i punës" është çdo vend i dedikuar për kryerjen e punës i vendosur në lokalet e punëdhënësit ose në një lokacion pune të përkohshëm ose lëvizës të cili i punësuarit ka qasje gjatë punës së tij dhe që është nën kontrollin direkt ose indirekt të punëdhënësit;

- "Ambienti i punës" është hapësira në të cilën kryhet puna, vendi i punës, kushtet për punë, proceset e punës, marrëdhëniet sociale, si dhe ndikimet tjera të ambientit të jashtëm;

- "Mjetet për punë" janë lokalet e punës dhe lokalet ndihmëse, pajisja për punë, pajisja për mbrojtje personale, substancat dhe preparatet dhe çdo mjet tjetër që shfrytëzohet gjatë procesit të punës ose në mënyrë tjetër është i lidhur me të njëjtën;

- “Pajisja për punë” është çdo makinë, aparat, mjet ose pajisje tjetër që shfrytëzohet në procesin e punës;
- “Rreziku” është mundësia për paraqitjen e lëndimit, sëmundjes ose dëmtimit të shëndetit të të punësuarit, si rezultat i rrezikut gjatë punës;
- “Deklarata për siguri” është dokument i cili i përshkruan karakteristikat e procesit të punës dhe përmban identifikimin e rreziqeve dhe vlerësimin e rrezikut për sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës dhe përcaktimin e masave adekuate për mbrojtje;
- “Personi profesional për siguri gjatë punës” është personi profesional i punësuar te punëdhënësi i caktuar nga ai për kryerjen e punëve profesionale të lidhura me sigurinë gjatë punës (në tekstin e mëtejme: personi profesional); dhe;
- “Institucioni shëndetësor i autorizuar” është institucioni shëndetësor në të cilin kryhet veprimtaria, medicina e punës, në pajtim me dispozitat nga sfera e shëndetësisë, i angazhuar nga ana e punëdhënësit për zbatimin e mbrojtjes shëndetësore gjatë punës.

#### Neni 4

(1) Qeveria e Republikës së Maqedonisë miraton Program për sigurinë dhe shëndetin gjatë punës (në tekstin e mëtejme: Programi).

(2) Me programin, përcaktohet strategjia për zhvillimin e sigurisë dhe shëndetit gjatë punës në lidhje me mbrojtjen e jetës, shëndetit dhe aftësisë së punës së të punësuarve dhe pengimin e lëndimeve gjatë punës dhe sëmundjeve profesionale dhe sëmundjeve tjera lidhur me punën.

## II. OBLIGIMET E PËRGJITHSHME TË PUNËDHËNËSIT

#### Neni 5

(1) Punëdhënësi ka obligime të garantojë sigurinë dhe shëndetin gjatë punës për të punësuarit e tij në çdo aspekt lidhur me punën. Në suazat e obligimeve të tija, punëdhënësi detyrimisht duhet të ndërmerr masa të duhura për sigurinë dhe shëndetin gjatë punës së të punësuarve, duke përfshirë mbrojtjen nga rreziqet profesionale, sigurimin e informatave dhe aftësimin dhe sigurimin e organizimit dhe mjetet e duhura adekuate.

(2) Punëdhënësi ka obligim që të miratojë masa të tilla mbrojtëse dhe të zgjedh metoda të tilla pune dhe metoda prodhuese që do ta përmirësojnë nivelin e sigurisë dhe shëndetit gjatë punës, ndërsa do të inkuadrohen në të gjitha veprimtaritë e punëdhënësit dhe në të gjitha nivelet e organizimit.

#### Neni 6

(1) Obligimet dhe punët e sigurisë dhe shëndetit gjatë punës të përcaktuara me këtë ligj, punëdhënësi mund t’ua besojë personave të autorizuar juridik ose fizik, nëse ai nuk ka mundësi ose nuk ka të punësuar adekuat profesional dhe pajisje teknike që punët e tilla dhe obligimet të kryejë në mënyrë të pavarur.

(2) Punëdhënësi është i detyruar që personave të autorizuar juridik dhe fizik t’ua jep të gjitha informatat dhe të dhënat e duhura për madhësinë e shoqërisë tregtare, institucionin dhe personat tjerë juridik, rreziqet që e rrezikojnë sigurinë dhe shëndetin e të punësuarve, aktivitetet e ndërmarra për sigurinë dhe shëndetin gjatë punës për ç’do vend pune dhe ambient.

(3) Angazhimi i personave fizik ose juridik të brendshëm ose të jashtëm kompetent dhe të autorizuar për kryerjen e detyrave profesionale në lidhje me sigurinë dhe shëndetin gjatë punës nuk e lirojnë punëdhënësin nga përgjegjësitë e tija në këtë sferë.

(4) Obligimet e të punësuarve në sferën e sigurisë dhe shëndetit gjatë punës nuk ndikojnë ndaj parimit për përgjegjësinë e punëdhënësit.

#### Neni 7

Personat e autorizuar juridik dhe fizik të cilët i ka angazhuar punëdhënësi, detyrimisht duhet të bashkëpunojnë midis tyre, si dhe me personat profesional për të gjitha çështjet lidhur me sigurinë preventive dhe shëndetin gjatë punës.

#### Neni 8

Punëdhënësi është i detyruar të planifikojë masa dhe mjete për sigurimin e zhvillimit dhe përparimin e sigurisë dhe shëndetit gjatë punës dhe për ndryshimin e proceseve teknologjike ekzistuese me procese me më pak rrezik, respektivisht me procese më të siguruara.

#### Neni 9

Punëdhënësi i zbaton masat për sigurinë dhe shëndetin gjatë punës në bazë të parimeve themelore si vijon:

- mënjanimin e rreziqeve;
- vlerësimin e rreziqeve që nuk mund mënjanohen;
- veprimi me rreziqet që në fillim;
- adaptimin e punës ndaj individit veçmas në lidhje me karakteristikat e vendit të punës dhe ambientit të punës;
- zgjedhja e pajisjes mbrojtëse personale;
- zgjedhjen e substancave ose preparateve kimike;
- zgjedhjen e metodave punuese dhe prodhuese;
- zbatimin e masave të duhura për ruajtjen dhe përforcimin e shëndetit;
- adaptimin ndaj përparimit teknologjik;
- zëvendësimin e rrezikut me parrezik ose me më pak të rrezikshme;
- zhvillimin e strategjisë së sigurisë së plotë që përfshin, teknologjinë, organizimin e punës, kushtet e punës, marrëdhëniet dhe faktorët ndërnjerëzor që ndikojnë ndaj ambientit të punës;
- dhënia e prioritetit masave të sigurisë kolektive përkundër masave të veçanta,
- sigurimin e udhëzimeve dhe instruksioneve adekuate dhe informimin e të punësuarve.

#### Neni 10

Punëdhënësi është i detyruar që procesin e punës ta adaptojë ndaj aftësive të të punësuarve gjatë së cilës ambienti i punës dhe mjetet për punë detyrimisht duhet të janë të siguruar dhe të pa rrezikshme ndaj shëndetit, duke marrë parasysh natyrën e punës.

#### Neni 11

(1) Çdo punëdhënësi doemos duhet të përgatitë dhe aplikojë deklaratë për siguri për çdo vend pune, duke e precizuar mënyrën, si dhe masat që duhet të ndërmerren.

(2) Nëse ndryshohen kushtet ose paraqitet rrezik i ri në vendin e punës dhe në ambientin e punës për të cilën paraprakisht është përgatitur deklaratë, punëdhënësi doemos duhet të bëjë deklaratë të re për siguri.

(3) Deklarata për siguri bazohet mbi identifikimin e rrezikut dhe vlerësimin e rreziqeve ndaj sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës dhe në ambientin e punës për të cilin ka të bëjë deklarata për siguri.

(4) Deklarata për sigurinë e vendit të punës përgatitet në gjuhën maqedonishte dhe alfabetin e saj cirilik dhe në gjuhë tjetër e cila është gjuhë zyrtare në rajonin e komunës.

(5) Mënyrën e përgatitjes së deklaratës të sigurisë, përmbajtjen e saj si dhe të dhënat mbi të cilat duhet të bazohet vlerësimi i rrezikut, i rregullon me rregullore ministri kompetent për çështjet nga sfera e punës në pajtim me ministrin kompetent për çështjet e shëndetësisë.

#### Neni 12

(1) Punëdhënësi e organizon sigurinë dhe shëndetin gjatë punës varësisht nga procesi teknologjik, me zbatimin e metodave shkencore-profesionale dhe në pajtim me arritjet bashkëkohore, me ç'rast punët profesionale të sigurisë do t'i kryejë punëtori me përgatitje profesionale adekuate me procesin teknologjik të punëdhënësit, ose do të shfrytëzojë shërbime të jashtme nga persona të autorizuar juridikë apo fizikë.

(2) Punëdhënësi është i detyruar që me marrëveshjen kolektive ta sigurojë realizimin e së drejtës të të punësuarve, drejtpërdrejt ose përmes përfaqësuesit të tij, të marrin pjesë në përcaktimin e mangësive dhe në përmirësimin e kushteve të punës dhe të ambientit të punës tek punëdhënësi, me ç'rast do të përfshihen të gjitha aktivitetet e ndërmarrjes ose të institucionit dhe i të gjitha niveleve të organizatës.

#### Neni 13

Punëdhënësi është i obliguar që gjatë planifikimit, furnizimit të pajisjes për punë dhe aplikimit të teknologjisë së re, të konsultohet dhe të bashkëpunojë me të punësuarit dhe përfaqësuesit e tyre për sa i përket pasojave dhe rreziqeve që dalin nga zgjedhja e pajisjes për punës, kushtet e punës dhe ambientit të punës.

#### Neni 14

(1) Punëdhënësi doemos duhet të sigurojë që qasja deri te vendet e punës, të ekspozuara në rrezik specifik dhe serioz, t'u lejohe vetëm atyre të punësuarve që kanë marrë udhëzime të posaçme për punë në vende të tilla të punës.

(2) Punëdhënësi doemos pajisjen për punë dhe mjetet e punës t'i sigurojë me shenja rreziku dhe kërcënimi për punë të sigurt në përputhje me rregullat e veçanta.

#### Neni 15

Në lokalitetet ku punojnë dy ose më shumë punëdhënës njëkohësisht, ata detyrimisht duhet të merren vesh me shkrim për masat e përbashkëta preventive dhe të sigurisë që duhet të ndërmerren dhe të emërojnë person profesional për zbatimin e masave të sigurisë gjatë punës.

#### Neni 16

(1) Sigurimi i masave të sigurisë dhe shëndetit gjatë punës nuk guxon të paraqesë obligim financiar për të punësuarit.

(2) Çrregullimi i shëndetit gjatë punës nuk guxon të ndikojë mbi pagën e të punësuarve, e as ta cenojë pozitën e tyre ekonomike dhe shoqërore.

#### Neni 17

Punëdhënësi doemos duhet të sigurojë masa të sigurisë dhe të shëndetit gjatë punës sidomos me:

- emërimin e një ose të më shumë personave profesionalë për siguri,
- angazhimin e institucionit të autorizuar shëndetësor për kryerjen e detyrave profesionale për shëndetin gjatë punës,
- miratimin e masave të sigurisë kundër zjarrit në përputhje me rregullat e veçanta,
- miratimin e masave për ndihmë të parë dhe evakuim në rast rreziku,
- trajnimin e të punësuarve për kryerje të sigurt të punës në bazë të programit vetjak,
- sigurimin e pajisjes për mbrojtje personale për të punësuarit dhe përdorimin e saj, nëse masat e ndërmarra të sigurisë në mjedisin e punës nuk janë të mjaftueshme,
- kryerjen e kontrolleve të herëpashershme dhe kontrollin e ambientit dhe të pajisjes për punë, dhe
- ndjekjen e gjendjes shëndetësore të të punësuarve.

#### Neni 18

(1) Punëdhënësi për kryerjen e punëve nga fusha e sigurisë gjatë punës doemos duhet të emërojë një ose më shumë persona profesionalë.

(2) Punëdhënësi do ta përcaktojë numrin, llojin dhe shkallën e arsimit profesional në pajtim me nenin 46 të këtij ligji, si dhe:

- organizimin,
- natyrën dhe vëllimin e procesit të punës,
- numrin e të punësuarve të përfshirë në procesin e punës,
- numrin e turneve të punës, dhe
- numrin e njërive të caktuara të punës.

(3) Gjatë kryerjes së detyrave profesionale që kanë të bëjnë me sigurinë gjatë punës, personat profesionalë për siguri, drejtpërdrejt përgjigjen para punëdhënësit.

(4) Punëdhënësi doemos duhet t'i sigurojë kushte (mjete) për punë, pavarësi të plotë personit profesional gjatë ushtrimit të detyrave të tij në pajtim me këtë ligj, doemos t'i lejojë kohë të duhur dhe qasje në të gjitha informatat e nevojshme dhe t'i mundësojë trajnim dhe aftësim profesional.

(5) Personi profesional nuk guxon të vihet në situatë të palakmueshme ose të ketë pasoja të paarsyeshme për shkak të aktiviteteve të tij lidhur me sigurinë dhe parandalimin e rreziqeve profesionale.

#### Neni 19

(1) Obligimet parësore të personit profesional janë:

- këshillimi i punëdhënësit për planifikimin, zgjedhjen, blerjen dhe mirëmbajtjen e mjeteve të punës,

- këshillimi i punëdhënësit për pajimin e vendit të punës dhe ambientit të punës,
- përgatitja e bazës profesionale për deklaratën e sigurisë,
- kryerja e kontrolleve të rregullta dhe kontrolluese nga rreziqet kimike, fizike ose biologjike në mjedisin e punës,
- kryerja e kontrolleve të rregullta dhe kontrolluese dhe testimin e pajisjes për punë,
- kryerja e mbikëqyrjes së brendshme mbi zbatimin e masave për realizim të sigurt të punës,
- përgatitja e udhëzimeve për zhvillim të sigurt të punës,
- ndjekja dhe analiza e lëndimeve lidhur me punën, sëmundjet profesionale, identifikimi i shkaqeve për të njëjtat dhe përgatitja e raporteve për punëdhënësin, bashkë me të gjitha masat e propozuara, dhe
- përgatitja e programit dhe realizimi i trajnimeve të të punësuarve për realizim të sigurt të punës.

(2) Personi profesional mund t'i kryejë detyrat e theksuara në alinetë 3, 4, 5 dhe 9 nga paragrafi 1 i këtij neni, nëse ka të dhënë provim profesional për siguri gjatë punës dhe i plotëson kushtet nga neni 46 i këtij ligji.

#### Neni 20

Detyra primare të institucionit shëndetësor të autorizuar në varshmëri nga lloji i veprimtarisë të cilën e kryen punëdhënësi, si dhe nga lloji i nivelit të rrezikut nga lëndimet ose prishja e shëndetit gjatë punës, janë:

- kryerja preventive e kontrolleve shëndetësore të të punësuarve në pajtim me dispozitat e veçanta;
- sigurimi i shërbimeve shëndetësore për të punësuarit me sëmundje profesionale;
- organizimi dhe sigurimi i ndihmës së parë të të punësuarve në rast të lëndimit në vendin e punës ose fatkeqësisë kolektive;

- konfirmimi dhe studimi i shkaqeve për invaliditet dhe sëmundje profesionale në lidhje me punën dhe lëndimet gjatë punës, propozimi i masave adekuate të sigurisë dhe masave për mjekim; pjesëmarrja në realizimin e rehabilitimit dhe konsultimit profesional adekuat për zgjedhjen e detyrave të punës më adekuate;

- dhënia e propozimeve dhe masa të punëdhënësit për mbrojtjen e shëndetit të të punësuarve të cilët i janë ekspozuar rrezikut të madh nga lëndimi ose çrregullimi i shëndetit;

- mbajtja e evidencës dhe grumbullimi i të dhënave për shëndetin e të punësuarve në pajtim me dispozitat e veçanta;

- pjesëmarrja në secilin vlerësim të rreziqeve, siguria dhe shëndeti në vendin e punës dhe ambienti i punës; dhe

- njohja e të punësuarit me rreziqet të cilat janë të lidhura me punën e tyre, vendin e punës së tyre dhe me kryerjen e edukimit.

#### Neni 21

Punët nga neni 20 të këtij ligji zbatohen nga ana e institucionit shëndetësor në të cilin kryhen veprimtaria mjekësi e punës në pajtim me dispozitat nga sfera e shëndetësisë, e autorizuar nga ministri kompetent për punët nga sfera e shëndetësisë.

#### Neni 22

(1) Punëdhënësi doemos duhet të sigurojë kontrolle shëndetësore për të punësuarit së paku në çdo 18 muaj.

(2) Llojin, mënyrën dhe vëllimin e kontrolleve shëndetësore më së afërmi i përcakton ministri kompetent për punët nga sfera e shëndetësisë, në pajtim me ministrin kompetent për punët nga sfera e punës

#### Neni 23

(1) Punëdhënësi është i obliguar që ta njoftojë organin e administratës shtetërore kompetent për çështjet e inspektimit të punës për fillimin me kryerjen e veprimtarisë, tetë ditë para fillimit me të njëjtën.

(2) Realizuesi i objekteve ndërtimore është i obliguar që para fillimit me punë ndërtimore ta njoftojë me shkrim organin e administratës shtetërore kompetent për inspektimin e punës, për vendin ku do të kryhen punët.

(3) Formularin për njoftim e përcakton ministri kompetent për çështjet nga sfera e punës.

### III. OBLIGIMET TJERA TË PUNËDHËNËSIT

#### 1. Mbrojtja nga zjarri, evakuimi dhe shpëtimi

##### Neni 24

(1) Punëdhënësi është i obliguar që në secilin objekt duke e marrë parasysh procesin teknologjik, materialet të cilat përdoren gjatë punës, mënyrën e punës, magazinimin e materialeve, si dhe madhësinë e objektit të ndërmarrë masa që të mos shkaktohet zjarr, ndërsa në qoftë se shkaktohet të zvogëlohet të masë sa më të vogël të mundshme rreziku ndaj sigurisë dhe shëndetit të të punësuarve dhe personave tjerë të pranishëm.

(2) Në varësi nga natyra e procesit të punës punëdhënësi është i obliguar që të organizojë dhe të sigurojë evakuimin, shpëtimin dhe ndihmën e parë në rast të situatës së qartë e cila mund ta rrezikojë sigurinë dhe shëndetin e tyre (fatkeqësi elementare, zjarre, shpërthime, lëshim i materieve të rrezikshme mbi kufirin e lejuar dhe ngjashëm) dhe t'i aftësojë personat të cilët do ta zbatojnë evakuimin dhe shpëtimin.

(3) Personat të cilët janë caktuar që ta zbatojnë evakuimin dhe shpëtimin, shuarjen e zjarrit dhe ndihmën e parë, punëdhënësi doemos duhet t'u vë në dispozicion pajisjen e nevojshme.

(4) Punëdhënësi është i obliguar të konfirmojë plan për evakuim dhe shpëtim në rast të situatës së jashtëzakonshme dhe me atë t'i njoftojë të gjithë të punësuarit dhe në bazë të atij plani doemos duhet të zbatohen ushtrime praktike së paku një herë në dy vjet.

(5) Punëdhënësi është i obliguar të organizojë dhe të sigurojë dhënien e ndihmës së parë të punësuarve në rast të lëndimeve gjatë punës ose sëmundjes së paparashikuar deri në dërgimin e tyre në mjekim në institucion shëndetësor.

(6) Në secilin vend pune dhe në lokale pune në të cilat njëkohësisht punojnë deri në 20 të punësuar së paku një prej tyre doemos duhet të jetë i aftësuar dhe i caktuar për dhënien e ndihmës së parë, për fikjen e zjarrit, evakuim dhe shpëtim, ndërsa mbi këtë numër në çdo njëzet të punësuar së paku edhe nga një.

(7) Punëdhënësi duhet të lidhë marrëveshje me subjekte tjera juridike të specializuara për dhënien e shërbimeve, veçanërisht në lidhje me dhënien e ndihmës së parë, ndihmën urgjente mjekësore, aktiviteteteve për evakuim dhe shpëtim dhe mbrojtje kundër zjarrit.

## **2. Informimi i të punësuarve**

### **Neni 25**

(1) Punëdhënësi doemos duhet që t'i informojë të punësuarit për kryerjen e sigurt të punës përmes njoftimeve dhe udhëzimeve me shkrim. Në raste të jashtëzakonshme, kur të punësuarit i janë ekspozuar rrezikut të drejtpërdrejtë për shëndetin ose jetën e tyre, njoftime dhe udhëzime të atilla që mund të barten edhe gojarisht dhe në atyre të mund t'u bashkëngjiten të gjitha masat e ndërmarra në lidhje me sigurinë gjatë punës.

(2) Në rast të rrezikut të drejtpërdrejtë, serioz dhe të pashmangshëm, punëdhënësi doemos duhet t'u japë të punësuarve udhëzime adekuate për ndërprerjen e punës, largimin e shpejtë nga vendi i punës dhe evakuimin në hapësirë të sigurt.

(3) Derisa zgjasin rreziqet, punëdhënësi nuk guxon që t'i obligojë të punësuarit të kryejnë detyra pune.

(4) Kur një ose më tepër të punësuar e kanë lëshuar vendin e punës ose zonën e rrezikshme, për shkak të rrezikut të drejtpërdrejtë ose të pashmangshëm për sigurinë e tyre gjatë punës, ata nuk guxojnë të merren në përgjegjësi për shkak të reagimit të tyre në raste të tilla.

(5) Punëdhënësi duhet të sigurojë që të gjithë të punësuarit gjatë rrezikut serioz ose të drejtpërdrejtë për sigurinë e tyre ose për sigurinë e personave tjerë edhe në rastet kur nuk mund të kontaktohet me personin profesional, të ndërmarrin masa adekuate në suazat e njohurive të tyre dhe mjeteve teknike të cilat i kanë në dispozicion të tyre, që t'u shmangen pasojave nga rreziku i tillë. Veprimi i tillë nuk guxon që t'i sjellë në situatë të merren në përgjegjësi, për veçanëse kanë vepruar pa kujdes dhe pa ndërgjegje.

### **Neni 26**

(1) Punëdhënësi doemos duhet t'i informojë të punësuarit dhe përfaqësuesit e tyre për çdo lloj rreziku në vendin e punës, si dhe për masat e sigurisë të nevojshme për kontrollin e rreziqeve dhe eliminimin e pasojave të dëmshme. Punëdhënësi doemos duhet që t'i informojë edhe të punësuarit me marrëveshje për punësim në kohë të caktuar, të punësuarit e rinj, të punësuarit më të moshuar në pajtim me Ligjin për marrëdhënie pune dhe ata me aftësi pune të zvogëluar për rezultatet nga vlerësimi i rreziqeve dhe për masat e ndërmarra nga ana e punëdhënësit, për shkak të garantimit të sigurisë dhe shëndetit të tyre gjatë punës.

(2) Punëdhënësi i cili i shfrytëzon të punësuarit e punëdhënësit tjetër në bazë të marrëveshjes, doemos duhet t'ua sigurojë të gjitha instruksionet, informatat për rreziqet për sigurinë dhe shëndetin gjatë punës, si dhe informatat për të punësuarit me përgjegjësi të veçanta për ndihmën e parë, mbrojtjen nga zjarri dhe evakuimi i të punësuarve.

(3) Në pajtim me dispozitat e veçanta, punëdhënësi doemos duhet të vë në vendin e punës dhe mjetet për punë, paralajmërime dhe shenja të veçanta për rrezik, si dhe udhëzime për sigurinë dhe shëndetin gjatë punës.

#### Neni 27

(1) Punëdhënësi doemos duhet t'u lejojë të punësuarve ose përfaqësuesve të tyre të marrin pjesë në diskutim për të gjitha çështje të cilat kanë të bëjnë me sigurinë dhe shëndetin gjatë punës në pajtim me këtë ligj dhe dispozita tjera të cilat kanë të bëjnë me sigurinë dhe shëndetin gjatë punës.

(2) Të punësuarve dhe përfaqësuesve doemos duhet t'u prezantohet raporti për siguri, i theksuar në nenin 3, alineja 10 të këtij ligji, raporti për siguri gjatë punës dhe masat e zbatuara për siguri dhe evidentimi i theksuar në nenin 37 të këtij ligji.

(3) Organizata sindikale ose tubimi i të punësuarve doemos duhet të konsultohet për të gjitha masat të cilat mund të ndikojnë ndaj sigurisë dhe shëndetit gjatë punës, për emërimin e personit profesional ose personit të autorizuar juridik ose fizik për siguri, planifikimi dhe organizimi i trajnimeve dhe për informimin e të punësuarve.

### **3. Përfaqësuesi i të punësuarve për siguri dhe shëndet në punë**

#### Neni 28

(1) Përfaqësuesin e zgjedhin të punësuarit nga radhët e tyre, në mbledhjen e sindikatës së sindikatës shumicë ose në mbledhjen e të punësuarve.

(2) Përfaqësuesi nga paragrafi (1) të këtij neni ka mbrojtje të veçantë nga marrëdhënia e punës që e ka edhe përfaqësuesi i sindikatës te punëdhënësi, në pajtim me ligjin dhe marrëveshjen kolektive.

#### Neni 29

(1) Numri i përfaqësuesve nga neni 28 të këtij ligji do të varet nga numri i të punësuarve, me atë që ai numër nuk mund të jetë më i vogël se:

- mbi njëzet të punësuar, zgjidhet një përfaqësues;
- dy përfaqësues në 101 deri 500 të punësuar; dhe
- tre përfaqësues te punëdhënësi të cilët kanë mbi 501 të punësuar.

(2) Numri i përfaqësuesve, mënyra e trajnimit të tyre, si dhe mënyra dhe forma e funksionimit të tyre rregullohet me aktin e punëdhënësit në pajtim me këtë ligj dhe me marrëveshjen kolektive.

(3) Përfaqësuesit nga paragrafi (1), alineja 2 dhe 3 të këtij neni nga radhët e tyre zgjedhin koordinator.

(4) Në çdo lokal pune ku ekziston rrezik për sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve pa marrë parasysh numrin e të punësuarve zgjidhet përfaqësues.

#### Neni 30

(1) Përfaqësuesi i të punësuarve ka të drejtë:

- t'i vizitojë vendet e punës për shkak të shikimit të gjendje në lidhje me sigurinë gjatë punës;
- të bisedojë me punëdhënësin për nevojat dhe problemet e sigurisë dhe të shëndetit gjatë punës;
- ta njoftojë inspeksionin e punës për ndërmjetësimin e tij, të marrë pjesë, t'i japë shikimet e veta dhe të ketë pasqyrë në procesverbalin e përpiluar nga ana e inspektorit;
- të kërkojë nga punëdhënësi informata dhe të ketë qasje te deklaratat për vlerësimin për siguri dhe raportet që janë obligim i punëdhënësit dhe te dokumentet tjera në lidhje me planifikimin dhe rregullimin e sigurisë dhe të shëndetit gjatë punës.

(2) Punëdhënësi doemos duhet t'i mundësojë përfaqësuesit kryerjen e funksionit të tij në mënyrë të papenguar, përmes sigurimit të kohës adekuate dhe mjeteve të nevojshme pa zvogëlimin e rrogës, me ç'rast nuk guxon ta vënë në gjendje të pavolitshme për shkak të aktiviteteve të tij.



#### **4. Trajnimi i të punësuarve**

##### **Neni 31**

(1) Punëdhënësi doemos duhet që secilit të punësuar t'i sigurojë trajnime adekuate për siguri dhe shëndet gjatë punës:

- gjatë punësimit,
- në rast të sistemimit në vend të ri pune,
- në rast të zbatimit të teknologjisë së re ose të mjeteve të reja për punë, dhe
- në rast të çdo ndryshimi të procesit të punës i cili mund ta ndryshojë nivelin e sigurisë dhe të shëndetit gjatë punës.

(2) Trajnimi për siguri dhe shëndetit gjatë punës doemos duhet t'u përshtatet specifikave të vendit të punës dhe doemos duhet të realizohet në pajtim me programin i cili doemos duhet të jetë i azhurnuar dhe e ndryshuar në pikëpamje të formave dhe llojeve të reja të rrezikut.

(3) Trajnimet teorike dhe praktike për realizimin e sigurt të punës zbatohen në kohën e punës te punëdhënësi ose në ndonjë vend tjetër.

(4) Punëdhënësi cakton provime të detyrueshme të rregullta teorike dhe praktike për realizimin e sigurt të punës për të gjithë të punësuarit në vendin e punës ku është konstatuar zmadhimi i rrezikut nga lëndimi dhe çrregullimi i shëndetit gjatë vlerësimit të rrezikut, si dhe për të gjithë ata të punësuar në vende të punës ku është zmadhuar numri i rasteve të lëndimeve gjatë punës dhe rrezikimit të shëndetit.

(5) Për të punësuarit nga paragrafi (4) të këtij neni punëdhënësi është i obliguar që në çdo tre vjet t'u sigurojë kontrollin e aftësisë për siguri dhe shëndet gjatë punës.

(6) Organizimi dhe zbatimi i trajnimit të të punësuarve dhe përfaqësuesve të tyre do të jenë në ngarkesë të punëdhënësit.

(7) Inspektori i punës pas zbatimit të mbikëqyrjes inspektuese mund të urdhërojë që programi i përhershëm për trajnim për siguri dhe shëndet gjatë punës t'u përshtatet specifikave të vendit të punës në lidhje me format dhe llojet e rrezikut.

(8) Në raste të tilla, inspektori mund të urdhërojë përsëritjen e trajnimit përmes aftësimin teorik dhe praktik të të punësuarve për siguri gjatë punës.

##### **Neni 32**

Përfaqësuesi ka të drejtë në trajnim të veçantë për siguri dhe shëndet gjatë punës specifike për veprimtarinë e punëdhënësit, me kushte të parashikuara me marrëveshje kolektive.

#### **5. Shqyrtimi i vendit të punës, mjedisit dhe mjeteve për punë**

##### **Neni 33**

(1) Punëdhënësi është i obliguar që mjetet për punës t'i mbajë në gjendje të rregullt, ta kontrollojë rregullsinë dhe sigurinë për punë me kontrole dhe shqyrtime të herëpashërme të cilat i kryejnë në mënyrë dhe në afate të përcaktuara me aktin që e miraton ai, përkatësisht me udhëzimin e prodhuesit, dispozitat dhe standardet teknike.

(2) Nëse me udhëzimin e prodhuesit dhe me dispozitat tjera nga paragrafi (1) të këtij neni nuk janë parashikuar afate tjera, punëdhënësi është i obliguar që mjetet për punë nga paragrafi (1) të këtij neni t'i kontrollojë dhe provojë:

- para përdorimit të parë;
- pas rikonstruktimit ose avarisë; dhe
- pas zhvendosjes nga një vend në vend tjetër (eskavator dhe ngjashëm).

(3) Punëdhënësi nuk guxon të vë në përdorim mjete për punë të cilat nuk janë kontrolluar dhe provuar për punë të sigurt, gjegjësisht nëse nuk janë në rregull për punë të sigurt, as po i punësuarit nuk guxon të përdorë mjete të tilla për punë.

#### Neni 34

(1) Punëdhënësi është i obliguar që në lokalet e punës dhe lokalet ndihmëse në të cilat zhvillohen procese teknologjike të bëjë analizën e dëmeve kimike, biologjike dhe fizike, të mikroklimës dhe të ndriçimit.

(2) Punëdhënësi është i obliguar që kontrollet mikroklimatike t'i bëjë në periudhën verore dhe dimërore gjatë kohës së procesit të punës.

#### Neni 35

Kontrollet nga neni 34 i këtij ligji, punëdhënësi është i obliguar t'i bëjë më së voni në afat prej një viti nga dita e fillimit me punë, përkatësisht pas secilit ndryshim të procesit teknologjik, rikonstruktimit të objektit, rikonstruktimit të sistemit të ajrosjes, ngrohjes dhe kondicionimit të ajrit ose gjatë ndryshimit të bërë të pajisjes teknologjike.

### **6. Evidencat dhe raportet**

#### Neni 36

(1) Punëdhënësi është i obliguar që menjëherë, ndërsa më së voni në afat prej 48 orësh pas ngjarjes, me shkrim ta njoftojë organin e administratë shtetërore kompetent për punët e inspektimit të punës, për:

- çdo rast të vdekjes;
- fatkeqësi kolektive dhe lëndime gjatë punës të cilat shkaktojnë paaftësim të përkohshëm për punë më tepër se tri ditë pune; dhe
- për çdo dukuri e cila paraqet rrezik të drejtpërdrejtë dhe e rrezikon sigurinë e të punësuarve gjatë punës.

(2) Njoftimi i punëdhënësit nga paragrafi (1) të këtij neni krahas të dhënave të përgjithshme përmban dhe përshkrimin e shkurtër të ngjarjes dhe të pasojave të saj.

#### Neni 37

(1) Punëdhënësi është i detyruar të mbajë evidencë për:

- trajnimin profesional dhe aftësimin e të punësuarve për punë të sigurt;
- kontrollet e bëra të mjeteve për punë;
- ekzaminimet e bëra të dëmtuesve fizikë, kimikë dhe biologjikë dhe të mikroklimës në lokalet e punës dhe lokalet ndihmëse, përkatësisht në vendet e punës;
- kontrollet paraprake dhe periodike të të punësuarve; dhe
- sëmundjet profesionale, sëmundjet në lidhje me punën, lëndimet gjatë punës dhe rastet e vdekjes gjatë punës.

(2) Evidenca nga paragrafi (1) i këtij neni i përmban të gjitha dokumentet teknike, dokumentet vetjake, raportet, konstatimet, mendimet dhe ngjashëm.

(3) Ministri kompetent për punët nga sfera e punës me rregullore e përcakton mënyrën e mbajtjes së evidencës nga paragrafi (1) i këtij neni.

## **IV. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E TË PUNËSUARVE**

#### Neni 38

(1) E drejtë dhe detyrë e çdo të punësuarit është që të kujdeset për sigurinë dhe shëndetin personal dhe për sigurinë dhe shëndetin e personave tjerë të cilët punojnë me të, në pajtueshmëri me trajnimet dhe instruksionet të cilat i janë dhënë nga ana e punëdhënësit, të njoftohet me masat për siguri dhe shëndet gjatë punës dhe të jetë i trajnuar për zbatimin e tyre.

(2) E drejtë dhe detyrë e çdo të punësuarit është që t'i japë propozime, mendime dhe vërejtje për sigurinë dhe shëndetin gjatë punës personit profesional dhe institucionit të autorizuar shëndetësor.

#### Neni 39

(1) I punësuar i ka të drejtë të refuzojë zbatimin e punës nëse paraprakisht nuk është informuar për të gjitha rreziqet dhe dëmtimet e mundshme, ose nëse punëdhënësi nuk e siguron kontrollin e përcaktuar shëndetësor.

(2) I punësuar i ka të drejtë të refuzojë zbatimin e punës, nëse i është ekspozuar rrezikut të drejtpërdrejtë ndaj shëndetit ose ndaj jetës, kur nuk janë zbatuar masat e sigurisë dhe të kërkojë mënjanimin e tyre.

(3) Nëse punëdhënësi nuk e mënjanon rrezikun ose nuk vepron në pajtim me mendimin e institucionit të autorizuar shëndetësor, i punësuar i mund të kërkojë intervenim nga inspektori kompetent për punë dhe ta njoftojë përfaqësuesin.

#### Neni 40

I punësuar i mund të punojë në vendin e punës ose në kushte të ekspozimit të rrezikut të zmadhuar nga lëndimi ose çrregullimi i shëndetit (punë gjatë shtypjes ajrore të zmadhuar ose të zvogëluar, temperatura të larta ose të ulëta, rrezatime të dëmshme, vibracione të mëdha, zhurmë, punë me të sëmur me sëmundje ngjitëse dhe me materie infektuese, punë në ujë dhe lagështi, punë të rëndë fizike, punë në terren të ekspozuar kushteve të fatkeqësive atmosferike dhe rreziqeve tjera, punë në kushte ndriçimit të pamjaftueshëm ose ndriçimit të fuqishëm, punë në lokale të ndotura me dëmtime kimike, punë në tokë ose në ujë, punë në lartësi ose thellësi, punë të personelit të aviacionit dhe ngjashëm) vetëm në bazë të vlerësimit të institucionit të autorizuar shëndetësor me të cilin vërtetohet aftësia e të punësuarit për punën përkatëse.

#### Neni 41

(1) Të punësuarit doemos duhet t'i respektojnë masat e përcaktuara për shfrytëzimin e drejtë të mjeteve për punë (makina, aparate, vegla, substanca të rrezikshme, pajisje për transport dhe mjete tjera për prodhim) dhe nuk guxon t'i shkyçë, ndryshojë ose mënjanojë aparatet mbrojtëse të pajisjes.

(2) Të punësuarit doemos duhet t'i respektojnë masat e përcaktuara për siguri dhe shëndet gjatë punës dhe ta shfrytëzojnë pajisjen e përcaktuar për mbrojtje personale dhe pas përdorimit ta kthejnë në vendin përkatës, si dhe të bëjnë kontrolle shëndetësore në pajtim me këtë ligj dhe dispozitat e tjera nga kjo sferë.

(3) Nëse i punësuar i nuk vepron në pajtim me dispozitat nga paragrafi (2) i këtij neni, konsiderohet se ai e ka ekspozuar në rrezik jetën dhe shëndetin personal, si dhe jetën dhe shëndetin e të punësuarve të tjerë.

#### Neni 42

(1) I punësuar i doemos duhet ta njoftojë punëdhënësin e vet, përmes përfaqësuesit, me gojë ose me shkrim, për çdo mangësi, rrezik ndaj sigurisë dhe shëndetit ose për incident tjetër me të cilin mund ta rrezikohet siguria dhe shëndeti i tij dhe siguria dhe shëndeti i të punësuarve të tjerë.

(2) Nëse punëdhënësi nuk ndërmerr masa për mënjanimin e dukurive nga paragrafi (1) i këtij neni ose nëse i punësuar i konsideron se nuk janë zbatuar masat përkatëse për siguri dhe shëndet, i punësuar i mund të kërkojë intervenim nga inspektorati kompetent për punë.

(3) I punësuar i doemos duhet që përherë të bashkëpunojë me punëdhënësin dhe personin profesional derisa të sigurohet ambient i sigurt pune dhe kushte pune si dhe zbatimi i masave të imponuara nga inspektorati kompetent i punës.

### V. KËSHILLI PËR SIGURI DHE SHËNDET GJATË PUNËS

#### Neni 43

(1) Qeveria e Republikës së Maqedonisë formon Këshill për siguri dhe shëndet gjatë punës (në tekstin e mëtujuar: Këshill), si trup ekspert këshillëdhënës.

- (2) Këshilli shqyrton dhe jep mendim dhe udhëzime për:
- programin;
  - gjendjen në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë punës, strategjinë për politikë koherente për parandalimin dhe zvogëlimin e lëndimeve në vendin e punës, sëmundjet profesionale dhe sëmundjet dhe lëndimet tjera të cilat janë të lidhura me punën;
  - bazat profesionale për përpunimin e ligjeve dhe dispozitave tjera për siguri dhe shëndet gjatë punës; dhe
  - dokumentet e organizatave ndërkombëtare lidhur me sigurinë dhe shëndetin gjatë punës.

#### Neni 44

(1) Këshillin e përbëjnë 15 anëtarë nga të cilët katër anëtarë, nga organizatat reprezentative të punëdhënësve, katër anëtarë nga sindikatat reprezentative, tre anëtarë të emëruar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, një anëtar përfaqësues i fakultetit i cili zbaton veprimtari arsimore në fushën e mjekësisë së punës, një anëtar përfaqësues i shoqatës së personave profesionalë për siguri gjatë punës dhe një anëtar përfaqësues i shoqatës së eksperteve të mjekësisë së punës.

(2) Gjatë emërimit të anëtarëve të Këshillit duhet pasur parasysh parimi për përfaqësim të drejtë dhe adekuat të të gjitha bashkësive në Republikën e Maqedonisë, duke mos e prishur parimin e profesionalizmit dhe të kompetencës.

### VI. AUTORIZIMI

#### Neni 45

(1) Ministri kompetent për punët nga sfera e punës personit juridik ose fizik i cili i plotëson kushtet lidhur me të punësuarit, organizatën, kushtet teknike dhe të tjera, i lëshon leje për kryerjen e punëve profesionale si vijon:

- vlerësimin e rizikut;
- testimin dhe kontrollimin e rregullt të pajisjes së punës;
- konceptin e deklaratës për siguri;
- përpunimin dhe zbatimin e programeve për trajnimin e të punësuarve për zbatimin e sigurt të punës; dhe

- kryerjen e matjeve e kushteve periodike të dëmtimeve kimike, fizike dhe të të kushteve të dëmtimeve biologjike mikroklimatike në mjedisin e punës.

(2) Ministri kompetent për punët nga sfera e punës e tërheq lejen për punë nga paragrafi (1) i këtij neni, në këto raste:

- pas përcaktimit se personi fizik dhe juridik nuk i plotëson kushtet e domosdoshme për lëshimin e lejes;
- personi fizik dhe juridik të cilit i është lëshuar leje nuk i zbaton detyrat e precizuara në leje pas një viti nga lëshimi i saj;
- leja është e lëshuar në bazë të të dhënave të rrejshme; dhe
- me propozimin e inspektorit për punë, nëse është e vërtetuar se punët nuk kryhen në nivelin profesional.

(3) Ministri kompetent për punët nga sfera e punës lëshon ose tërheq leje me aktvendim i cili është përfundimtar.

(4) Kundër aktvendimit përfundimtar mund të paraqitet padi për ngritjen e kontestit administrativ para gjykatës kompetente.

(5) Shpenzimet për zbatimin e procedurës nga paragrafi (3) të këtij neni bien në ngarkesë të personit juridik ose fizik.

(6) Për lejet e lëshuara ose të tërhequra për kryerjen e punëve profesionale nga paragrafi 1 i këtij neni, ministria kompetente nga sfera e punës mban evidencë.

(7) Të dhënat e evidencës nga paragrafi (6) i këtij ligji janë të kapshme për publikun.

#### Neni 46

(1) Ministri kompetent për punët nga sfera e punës me rregullore i përcakton kushtet për të punësuarit, organizatën, kushtet teknike dhe të tjera të cilat duhet t'i plotësojë personi juridik ose fizik për kryerjen e punëve profesionale.

(2) Ministri kompetent për punën nga sfera e punës me rregullore i përcakton kushtet, mënyrën dhe programin për dhënien e provimit profesional për siguri dhe shëndet gjatë punës.

#### Neni 47

Aktet nënligjore në lidhje me sigurinë dhe shëndetin gjatë punës i miraton ministri kompetent për punët nga sfera e punës, ndërsa aktet nënligjore për sfera të caktuara ministri kompetent për punët e punës në pajtim me ministrin kompetent për punën nga sfera me të cilën ka të bëjë akti nënligjor.

### VII. MBIKËQYRJA

#### Neni 48

Mbikëqyrjen ndaj zbatimit të dispozitave të këtij ligji e kryen Ministria kompetente për punët nga sfera e punës, ndërsa mbikëqyrjen e inspektimit në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë punës e kryen Inspektorati shtetëror për punë në bazë të këtij ligji dhe Ligjit për inspektimin e punës.

#### Neni 49

(1) Nëse inspektori i punës vërteton cenimin e ligjit ose të dispozitës tjetër për siguri dhe shëndet gjatë punës, marrëveshjen kolektive dhe marrëveshjen për punësim, me të cilat rregullohen të drejtat dhe detyrimet nga sfera e sigurisë dhe shëndetit gjatë punës, ndaj zbatimit të së cilës kryen mbikëqyrje inspektimi, me aktvendim do të urdhërojë që në afat të caktuar të mënjanohej parregullsitë dhe mangësitë e përcaktuara.

(2) Nëse inspektori i punës në bazë të mbikëqyrjes ndaj sigurisë të punëdhënësi vërteton se ekziston rrezik i drejtpërdrejtë ndaj sigurisë dhe shëndetit gjatë punës së të punësuarve, me aktvendim do ta ndalojë punën në tërësi ose në një pjesë të pajisjes për punë, në një pjesë të reparteve ose të gjithë procesit teknologjik.

(3) Inspektori i punës do të ndalojë punën e punëdhënësit nëse ai nuk vepron sipas aktvendimit të inspektorit të punës dhe në afat të caktuar nuk i mënjanon parregullsitë dhe mangësitë e përcaktuara.

(4) Nëse cenimi i vërtetuar i dispozitave për siguri dhe shëndet gjatë punës paraqet mungesë për mënjanimin e së cilës nevojiten depozitime të veçanta investuese, ndërsa jeta dhe shëndeti i të punësuarve nuk janë drejtpërdrejtë të rrezikuar, inspektori për punë me aktvendim mund t'i urdhërojë punëdhënësit të miratojë program të veçantë për harmonizim gradual të gjendjes ekzistuese, në pajtim me dispozitat.

#### Neni 50

(1) Inspektori i punës është i detyruar që pas marrjes së njoftimit për ndërmjetësim menjëherë të bëjë mbikëqyrje dhe me aktvendim të urdhërojë ndërmarrjen e masave përkatëse për siguri dhe shëndet gjatë punës, përkatësisht nëse sipas konstatimit nga mbikëqyrja vërteton se ekziston rrezik i drejtpërdrejtë ndaj jetës dhe shëndetit të të punësuarve, menjëherë me aktvendim ta ndalojë punën në vendin e punës, të pajisjes për punë, përkatësisht në një pjesë të procesit teknik-teknologjik ose të tërësisë së tij.

(2) Ndalesat nga paragrafi (2) dhe (3) i këtij neni do të zgjasin deri sa nuk zbatohen masat e nevojshme për siguri dhe shëndet gjatë punës, përkatësisht derisa nuk mënjanohej rreziku i drejtpërdrejtë ndaj jetës dhe shëndetit të të punësuarve gjatë punës.

Neni 51

Kundër aktvendimit të inspektorit të punës mund t'i paraqitet ankesë ministrit kompetent për punët nga sfera e punës në afat prej 8 ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit.

VIII. DISPOZITAT PËR KUNDËRVAJTJE

Neni 52

**Organi për kundërvajtje**

(1) Për kundërvajtjet e vërtetuara në nenin 56 dhe 57 të këtij ligji, procedurë për kundërvajtje mban edhe sanksion kundërvajtës kumton organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e punës (në tekstin e mëtutjeshëm: Organi për kundërvajtje).

(2) Procedurën për kundërvajtje nga paragrafi (1) të këtij neni para organit për kundërvajtje e mban komisioni për vendimmarrje sipas kundërvajtjes (në tekstin e mëtutjeshëm: Komisioni për kundërvajtje) i formuar nga ana e ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e punës.

(3) Komisioni për kundërvajtje përbëhet nga persona zyrtarë të punësuar në organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e punës prej të cilëve njëri e kryen funksionin kryetar i Komisionit për kundërvajtje.

(4) Komisioni për kundërvajtje përbëhet nga tre anëtarë, prej të cilëve:

- dy juristë të diplomuar, prej të cilëve njëri me provimin e dhënë të jurisprudencës me pesë vjet përvojë pune në fushën e tyre, dhe

- një anëtar me përgatitje sipërore profesionale në fushën e shkencave teknike, me pesë vjet përvojë pune në sferën e tij.

(5) Komisioni për kundërvajtje zgjidhet me kohëzgjatje prej 3 vjetësh me të drejtë rizgjedhje të anëtarëve.

(6) Për kryetar të Komisionit për kundërvajtje mund të zgjidhet vetëm juristi i diplomuar.

(7) Komisioni për kundërvajtje për organin për kundërvajtje vendos sipas kundërvajtjeve të përcaktuara në këtë ligj ose ligj tjetër dhe kumton sanksione për kundërvajtje të përcaktuara me këtë ligj, Ligjin për kundërvajtjet dhe/ose me ligj tjetër.

(8) Përveç anëtarëve të Komisionit për kundërvajtje, ministri i cili udhëheq me organin kompetent për punët nga sfera e punës, mund të caktojë sekretar të Komisionit për kundërvajtje i cili kryen punë administrative për komisionin dhe zëvendës-anëtarë të cilët me përjashtim, marrin pjesë me punën e Komisionit për kundërvajtje në rast mungese të njërit prej anëtarëve.

(9) Komisioni për kundërvajtje miraton rregullore për punën e vet.

(10) Kundër aktvendimit të Komisionit për kundërvajtje, me të cilin kumtohet sanksion për kundërvajtje, mund t'i paraqitet ankesë për ngritjen e kontestit administrative gjyqit kompetent.

Neni 53

**Puna e Komisionit për kundërvajtje**

(1) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e punës mund të formojë më tepër komisione për kundërvajtje, të cilat do të jenë kompetente për mbajtjen e procedurës për kundërvajtje për kundërvajtje në sfera të caktuara dhe/ose për rajone të caktuara nga Republika e Maqedonisë.

(2) Anëtari i Komisionit për kundërvajtje mund të shkarkohet:

- me skadimin e kohës për të cilën është emëruar për anëtar;

- me kërkesën e tij;

- me plotësimin e kushteve për pension pleqërie në pajtim me ligjin;

- nëse është dënuar me aktvendim gjyqësor të plotfuqishëm për vepër penale;

- nëse i vërtetohet paaftësia e përhershme;

- nëse vërtetohet cenimi i dispozitave për mbajtjen e procedurës për kundërvajtje me aktvendim të plotfuqishëm;

- nëse nuk i plotëson detyrimet të cilat dalin nga puna në Komisionin për kundërvajtje; dhe

- nëse nuk ka lajmëruar ekzistimin e konfliktit të interesit për rastin për të cilin vendos Komisioni për kundërvajtje.

(3) Propozim për shkarkimin e anëtarit të komisionit për rastet nga paragrafi (2) alineja 3 deri në 8 të këtij neni i paraqet kryetari i Komisionit për kundërvajtje ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e punës.

(4) Komisioni për kundërvajtje ka të drejtë të nxjerrë dëshmi dhe të mbledhë të dhëna të cilat janë të domosdoshme për përcaktimin e kundërvajtjes, si dhe të kryejë punë të tjera dhe të ndërmarrë veprime të përcaktuara me këtë ligj, Ligjin për kundërvajtje dhe/ose me ligj tjetër.

(5) Anëtarët e komisionit për kundërvajtje janë të pavarur dhe të mëvetësishëm në punën e Komisionit për kundërvajtje dhe vendosin në bazë të njohurive të veta personale dhe bindjes së pavarur.

(6) Komisioni për kundërvajtje punon në këshill, ndërsa vendos me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.

(7) Organi për kundërvajtje mban evidencë unike të kundërvajtjeve, sanksioneve të kumtuara dhe vendimeve të marra në mënyrë të përcaktuar nga ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e punës me mendimin paraprak të ministrit i cili udhëheq me organin kompetent për punët nga sfera e drejtësisë.

(8) Anëtarët e Komisionit për kundërvajtje kanë të drejtë në shpërblim për punën e vet në Komisionin për kundërvajtje që e përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punën nga sfera e punës e cila duhet të jetë e kuptueshme dhe përkatëse me rëndësinë, vëllimin e punës dhe ndërlikimin e kundërvajtjeve.

#### Neni 54

##### **Barazimi**

(1) Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenin 56 të këtij ligji, inspektorët shtetërorë janë të obliguar që kryerësit të kundërvajtjes t'i propozojnë procedurë për barazim, para se të parashtrojnë kërkesë për procedurë kundërvajtëse.

(2) Kur kryerësi i kundërvajtjes pajtohet për ngritjen e procedurës për barazim, inspektori shtetëror përpilon procesverbal, në të cilin shënohen elementet e rëndësishme të kundërvajtjes, koha, vendi dhe mënyra e kryerjes së kundërvajtjes, përshkrimi i veprimit të kundërvajtjes dhe personat e ndodhur në vendin e ngjarjes.

(3) Në procesverbal përcaktohet mënyra në të cilën do të evitohen pasojat e dëmshme nga kundërvajtja, si dhe mënyra e tejkalimit të pasojave nga kryerja e kundërvajtjes.

(4) Inspektori shtetëror mundet t'i propozojë kryerësit që tejkalimi i pasojave nga kundërvajtja, të zëvendësohet me kryerjen e obligimeve të tjera që kontribuojnë për përmirësimin e kushteve të sigurisë dhe shëndetit të të punësuarve gjatë punës, të cilat deri atëherë nuk janë ndërmarrë ose realizuar nga kryerësi i kundërvajtjes.

(5) Inspektori shtetëror është i obliguar që të mbajë evidencë, për procedurat e ngritura për barazim dhe për rezultatin e tyre.

#### Neni 55

##### **Ndërmjetësimi**

(1) Për kundërvajtjet nga neni 58 i këtij ligji, inspektorët shtetërorë munden që kryerësit të kundërvajtjes t'i ofrojnë ndërmjetësim dhe arritjen e pajtimit, me të cilin kryerësi i kundërvajtjes duhet t'i evitojë pasojat e kundërvajtjes.

(2) Inspektori shtetëror për rastet nga paragrafi (1) i këtij neni, përpilon procesverbal në të cilin konstatohet pajtueshmëria e të dyja palëve për ngritjen e procedurës për ndërmjetësim, në të cilin nënshkruhet edhe kryerësi i kundërvajtjes.

(3) Procedura për ndërmjetësim ngrihet me kërkesën e inspektorit shtetëror, në afat prej 8 ditësh nga dita kur është konstatuar kryerja e kundërvajtjes.

(4) Pajtimi për ndërmjetësim duhet të arrihet në afatin prej 8 ditësh, nga dita kur ka filluar procedura për ndërmjetësim.

(5) Procedura për ndërmjetësim udhëhiqet para komisionit për ndërmjetësim, i formuar nga ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për çështjet nga sfera e punës.

(6) Komisioni përbëhet prej tre anëtarëve, nga të cilët njëri e kryen funksionin e kryetarit. Anëtarët e komisionit zgjidhen nga radhët e nëpunësve shtetërorë, të punësuar në organin e administratës shtetërore, kompetent për çështjet nga sfera e punës, prej të cilëve njëri është jurist i diplomuar.

(7) Kryetari është i obliguar që ta fillojë procedurën e komisionit, në afatin prej 24 orësh nga dita kur ka arritur kërkesa nga paragrafi (3) i këtij neni.

(8) Komisioni punon në mbledhje në të cilën detyrimisht marrin pjesë përfaqësuesit të kryerësit të kundërvajtjes dhe inspektori shtetëror.

(9) Për pajtimin e lidhur për ndërmjetësim, përpilohet marrëveshje në të cilën konstatohet pajtimi i të dyja palëve.

(10) Në marrëveshje përcaktohen obligimet e kryerësit të kundërvajtjes, e veçanërisht shpenzimet që duhet t'i ndërmarrë kryerësi, me qëllim që t'i evitohet pasojat nga kundërvajtja.

(11) Ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për çështjet nga sfera e punës, nxjerr rregullore dhe listën e shpenzimeve për punën e komisionit.

(12) Anëtarët e komisionit për ndërmjetësim, kanë të drejtë në shpërblim për punën e tyre në komision, i cili duhet të jetë i arsyeshëm dhe përkatës me rëndësinë, vëllimin e punës së anëtarëve dhe ndërlikueshmërinë e kundërvajtjeve.

(13) Lloji i shpenzimeve të përcaktuara në listën e shpenzimeve nga paragrafi (11) i këtij neni, përcaktohet në bazë të shpenzimeve reale që i ka organi, për sigurimin e punës së komisionit për ndërmjetësim.

(14) Komisioni për ndërmjetësim është i obliguar që të mbajë evidencë për procedurat e ngritura për ndërmjetësim dhe për përfundimin e tyre.

(15) Marrëveshja nga paragrafi (9) i këtij neni, e ka fuqinë e dokumentit përmbarues.

## Neni 56

### **Kundërvajtjet e kategorisë I**

(1) Gjoha në shumë prej 1.000 eurosh me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet për kundërvajtje personit juridik për veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni, nëse:

- nuk u mundëson të të punësuarve që drejtpërdrejt ose përmes përfaqësuesit të vet, të marrin pjesë në konfirmimin e mangësive dhe në përmirësimin e kushteve për punë, si dhe nuk konsultohet dhe bashkëpunon me të punësuarit dhe përfaqësuesit e tyre, për rreziqet dhe pasojat që rezultojnë gjatë zgjedhjes së pajisjes për punë (neni 13);

- për shkak të sigurimit të masave të sigurisë dhe shëndetit në punë, si dhe çrregullimit të shëndetit të të punësuarve, i vë si obligim financiar i personave të punësuar (neni 16);

- nuk lidh marrëveshje të nevojshme me shërbimet e jashtme, për shërbimet e veçanta nga sfera e sigurisë dhe shëndetit në punë (neni 24 paragrafi (8));

- përmes njoftimeve dhe udhëzimeve me shkrim, nuk i informon të punësuarit për kryerjen e punës në mënyrë të sigurt (neni 25 paragrafi (1) dhe (2));

- i vë në përgjegjësi të punësuarit që e kanë lëshuar vendin e punës, për shkak të rrezikut të ndodhur serioz dhe të pashmangshëm (neni 25 paragrafi (4));

- nuk i informon të punësuarit dhe përfaqësuesit e tyre, të punësuarit e përkohshëm si dhe të punësuarit e punëdhënësit tjetër, në bazë të marrëveshjes për punë, për çdo rrezik në vendin e punës, si dhe për masat e sigurisë për eliminimin e pasojave të dëmshme (neni 26 paragrafët (1) dhe (2));



- nuk u lejon të punësuarve dhe përfaqësuesve të tyre, që të marrin pjesë në diskutime për të gjitha çështjet, që kanë të bëjnë për sigurinë dhe shëndetin në punë (neni 27 paragrafi (1));
  - të punësuarve dhe përfaqësuesve të tyre, nuk ua prezanton deklaratën për siguri (neni 27 paragrafi (2));
  - nëse përfaqësuesit nuk ia mundëson kryerjen e papenguar të funksionit të tij (neni 30 paragrafi (2));
  - nuk mban evidencë për punët e përcaktuara në nenin 37 të këtij ligji.
- (2) Gjoha në shumë prej 300 eurosh me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet për kundërvajtje personit përgjegjës te personi juridik, për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni.

#### Neni 57

##### **Kundërvajtjet e kategorisë II**

- (1) Gjoha në shumë prej 2.000 eurosh me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet për kundërvajtje personit juridik, nëse:
- nuk cakton një apo më tepër persona përgjegjës për siguri në punë, në mjedisin e vet të punës (neni 17 alineja 1);
  - nuk e angazhon institucionin e autorizuar shëndetësor, për kryerjen e detyrave profesionale për shëndetin në punë (neni 17 alineja 2);
  - nuk miraton masa të sigurisë kundër zjarrit, sipas dispozitave të veçanta (neni 17 alineja 3);
  - nuk miraton masa për ndihmën e parë dhe evakuim, në rast rreziku (neni 17 alineja 4);
  - nuk e njofton organin e administratës shtetërore, kompetent për çështjet e inspektimit të punës, për fillimin e kryerjes së veprimtarisë, tetë ditë para fillimit me të njëjtën (neni 23 paragrafi (1));
  - para fillimit me punë ndërtimore, nuk e njofton me shkrim organin e administratës shtetërore, kompetent për inspektimin e punës, për vendin ku do të kryhen punët (neni 23 paragrafi (2));
  - nuk e përcakton planin për evakuim dhe shpëtim në situata të jashtëzakonshme (neni 24 paragrafi (4)); dhe
  - analizat nga neni 34 i këtij ligji, nuk janë kryer në afat prej një viti nga dita e fillimit të objektit me punë , përkatësisht pas secilit ndryshim të procesit teknologjik, rikonstruksionit të objektit, rikonstruksionit të instalimeve teknike ose gjatë ndryshimit të pajisjes teknologjike (neni (35));
- (2) Gjoha në shumë prej 500 eurosh me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet personit përgjegjës te personi juridik, për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni.

#### Neni 58

##### **Kundërvajtjet e kategorisë III**

- (1) Gjohë në shumë prej 5.000 deri në 8.000 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet për kundërvajtje personit juridik, nëse:
- nuk e përgatit dhe nuk e zbaton deklaratën me shkrim për siguri, ose ajo nuk është përpiluar sipas dispozitës nga neni 11 i këtij ligji (neni 11 paragrafi (1), (4));
  - e ka lejuar afrimin e personave të punësuar në vendet e punës, që u janë të ekspozuara rreziqeve serioze dhe specifike, ndërsa nuk kanë marrë udhëzime të veçanta për punë (neni 14);
  - nuk siguron trajnim të punësuarve, për kryerjen e punëve në mënyrë të sigurt (neni 31);
  - nuk e siguron pajisjen personale mbrojtëse për të punësuarit, si dhe përdorimin e saj (neni 17 alineja 6);
  - nuk kryen kontrole dhe analiza të herëpashershme të mjedisit dhe pajisjes së punës (neni 17 alineja 7);
  - nuk kryen kontrole shëndetësore të të punësuarve (neni 22);
  - nuk e organizon dhe siguron dhënien e ndihmës së parë të të punësuarve, në rastin e lëndimit në punë (neni 24 paragrafi (5));

- secilit të punësuar nuk i siguron trajnim përkatës për sigurinë dhe shëndetin në punë, përmes trajnimit teorik dhe praktik, për rastin e punësimit, sistemimit në vendin e ri të punës, aplikimit të teknologjisë së re ose të mjeteve për punë, si dhe gjatë ndryshimit të procesit të punës (neni 31 paragrafi (1));

- mjetet e punës nuk i mban në gjendje të rregullt, përmes kontrolleve dhe analizave të herëpashershme, në afatet e përcaktuara me aktin që e nxjerr ai, përkatësisht sipas udhëzimeve të prodhuesit, dispozitave dhe standardeve teknike (neni 33 paragrafi (1));

- lëshon në përdorim pajisjen për punë që nuk është provuar për punë në mënyrë të sigurt (neni 33 paragrafi (3));

- në lokalet e punës dhe ndihmëse, nuk e kryen analizën e dëmeve kimike, biologjike, fizike, mikroklimës dhe ndriçueshmërisë (neni 34); dhe

- në afatin prej 48 orësh, nuk e njofton organin shtetëror kompetent për çështjet e inspektimit të punës për çdo rast vdekjeje, fatkeqësisë kolektive, paaftësisë së përkohshme për punë më gjatë se 3 ditë, dhe për secilën dukuri që paraqet rrezik të drejtpërdrejtë dhe e rrezikon sigurinë e të punësuarve gjatë punës (neni 36).

(2) Gjobë në shumë prej 500 deri në 1.000 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet për kundërvajtje personit përgjegjës te personi juridik, për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Organ kompetent për udhëheqjen e procedurës kundërvajtëse dhe kumtimin e sanksioneve kundërvajtëse nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, është gjykata kompetent.

#### Neni 59

Me gjobë (dënim mandator aty për aty) prej 50 eurosh me kundërvlerë në denarë, do të dënohet i punësuar nëse nuk i respekton masat e përcaktuara për sigurinë dhe shëndetin në punë, dhe nuk e shfrytëzon pajisjen e përcaktuar për mbrojtje personale (neni 41 paragrafi (1) dhe (2)).

### IX. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

#### Neni 60

Punëdhënësit na afat prej dy vitesh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, doemos duhet ta përgatisin dhe zbatojnë deklaratën për siguri, në pajtim me nenin 11 paragrafin (1) të këtij ligji.

#### Neni 61

Personat juridikë të cilët sipas nenit 33 të Ligjit për mbrojtje në punë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", numër 13/98) dhe Rregullores për kushtet që duhet t'i plotësojnë personat juridikë, për marrjen e autorizimit për kryerjen e punëve të caktuara për mbrojtje në punë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, numër 71/2003), kanë marrë autorizim për kryerjen e punëve të caktuara për mbrojtje në punë, do të harmonizohen me dispozitat e këtij ligji, në afat prej një viti nga dita e hyrjes së tij në fuqi, ndërsa deri në atë periudhë vazhdojnë që t'i kryejnë punët sipas autorizimeve të marra.

#### Neni 62

Aktet nënligjore nga neni 11 paragrafi (4), neni 22, neni 23 paragrafi (2), neni 37 paragrafi (3), neni 53 paragrafi (7) dhe neni 46 të këtij ligji, do të nxirren në afat prej tre muajsh, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

#### Neni 63

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, pushon të vlejë Ligji për mbrojtje gjatë punës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 13/98, 33/2000 dhe 29/2002).

#### Neni 64

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë".